

PROCESVERBAL
nga seanca e 5-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 12.03.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr.Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr.Emilija Janevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Ilija Tanevski nga Radio ALEKSANDAR MAKEDONSKI Kërçovë dhe Goce Trpkovski gazetar nga Prizma.

Z. Petrushevski hapi seancën e 5-të publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 10:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota „pro“, miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Arsyetim nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO ALEKSANDAR MAKEDONSKI Ilija Tanevski Kërçovë SHPKNJP, në lidhje me procedurën për fshirjen nga regjistri i transmetuesve.
2. Arsyetim nga HIT Radio Shkup, në lidhje me procedurën për fshirjen nga regjistri i transmetuesve.
3. Arsyetim nga Radio USKANA-PLUS Kërçovë, në lidhje me procedurën për fshirjen nga regjistri i transmetuesve.
4. Të ndryshme.

Z. Petrushevski shpjegoi se seancat publike të Këshillit, caktohen dhe mbahen në pajtim me LSHMAAV, i cili parashikon që përveç rasteve kur merret vendim për heqjen e lejes, ato të mbahen edhe në rastin kur Shoqëritë Tregtare Radiodifuzive fshihen nga regjistri i transmetuesve. Në seancë do të kenë mundësi të japin shpjegimet e tyre për gjendjen e medias. Lidhur me këtë, ai shpjegoi se në seancë është i pranishëm dhe përfaqësues nga SHTR RA Aleksandar Makedonski, i cili do t'i drejtohet Këshillit, ndërsa dy pikat e tjera nuk do të mbahen sepse nuk ka përfaqësues të tyre.

Pika 1

Arsyetim nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO ALEKSANDAR MAKEDONSKI Ilija Tanevski Kërçovë SHPKNJP, lidhur me procedurën për fshirjen nga regjistri i transmetuesve:

Përfaqësuesi nga SHTR RA Aleksandar Makedonski nga Kërçova, shpjegoi se pritshmëritë e tij janë që gjatë kësaj jave llogaria e radios do të zhbllokohet, në tërësi do të paguajnë kompensimin vjetor për lejen Agjencisë dhe do të paraqesin padi para Gjykatës Administrative për kthimin e lejes për transmetim në radio. Me këtë do të tejkalohej të gjitha pengesat dhe do të vazhdojnë të punojnë dhe në të ardhmen.

Z. Petrushevski tha se ky është një lajm i mirë dhe pret që gjithçka të përfundojë me sukses. Ai shpjegoi se ndoshta reklamat gjatë fushatës zgjedhore do të ndihmojë radion të rigjadhërohet financiarisht. Ai theksoi se gjithçka që është e lejuar me ligj, Agjencia do ta zbaton në mënyrë që transmetuesi të rifitojë lejen.

Pika 2

Nuk kishte përfaqësues nga HIT Radio Shkup.

Pika 3

Nuk kishte përfaqësues nga Radio USKANA-PLUS Kërçovë.

Pika 4

Të ndryshme

Nuk kishte diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetar i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**